



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIVJAKË  
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr 1079 / Prot. 3

Divjakë më 10 / 02 / 2025

PROJEKT-VENDIM

Nr 10 Datë 10/02 /2025

**“PËR NJË SAKTËSIM NË VENDIMIN NR.58, DATË 25.11.2024” PAKETA FISKALE PËR SISTEMIN E TAKSAVE E TARIFAVE VENDORE DHE PENALITETET PËR KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE PËR VITIN 2025”**

Mbështetur në: Ligjin Nr. 139/2015 , datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ”,(i ndryshuar), Ligjin nr 68/2017, datë 27.04.2017 “ Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”,( i ndryshuar), me ligjin nr.67/2023 datë 21.07.2023 “ Për një ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, I propozon Këshillit të Bashkisë Divjakë, që në mbledhjen e datës 24 / 02 / 2025:

1.Të bëjë një saktësim në Vendimin e Këshillit Bashkiak,nr.58 datë 25.11.2024” Paketa Fiskale për Sistemin e Taksave e Tarifave Vendore dhe Penalitetet për Kundërvajtjet Administrative Për Vitin 2025”, në zbatim të Ligjit nr.67/2023 datë 21.07.2023 “ Për një ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “ Për sistemin e taksave vendore”, si më poshtë:

- Në pikën 5, të Kreut të II-të, Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë:

Ishte:

| Taksa e ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.  | Niveli                                      |
|---|---|
| 1-Leje për objektet bujqësore dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blektorale, përfshirë ato frigoriferike, për përpunim të produkteve primare bujqësore e blektorale, stallave apo serave, objekte për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve, sera me themel të vazhduar e pika shërbimi $\leq 500$ m/2. | Niveli i taksës 2% e vlerës së investimit   |
| 2-Leje për objektet bujqësore dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blektorale, përfshirë ato frigoriferike, për përpunim të produkteve primare bujqësore e blektorale, stallave apo serave, objekte për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve, sera me themel të vazhduar e pika shërbimi 501-1000 m/2.   | Niveli i taksës 3.5% e vlerës së investimit |



|  |   |
|--|---|
| <p>3-Leje për objektet bujqësore dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blektorale, përfshirë ato frigoriferike, për përpunim të produkteve primare bujqësore e blektorale, stallave apo serave, objekte për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve, sera me themel të vazhduar e pika shërbimi &gt;1000 m<sup>2</sup>.</p> | <p><b>Niveli i taksës 1% e vlerës së investimit</b></p> |
|--|---|

**Të saktësohet:**

| <b>Taksa e ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja.</b>  | <b>Niveli</b>   |
|--|---|
| <p>1-Leje për objektet bujqësore dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blektorale, përfshirë ato frigoriferike, për përpunim të produkteve primare bujqësore e blektorale, stallave apo serave, objekte për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve, sera me themel të vazhduar e pika shërbimi ≤ 500 m<sup>2</sup>.</p>    | <p><b>Niveli i taksës 1% e vlerës së investimit</b></p> |
| <p>2-Leje për objektet bujqësore dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blektorale, përfshirë ato frigoriferike, për përpunim të produkteve primare bujqësore e blektorale, stallave apo serave, objekte për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve, sera me themel të vazhduar e pika shërbimi 501-1000 m<sup>2</sup>.</p> | <p><b>Niveli i taksës 1% e vlerës së investimit</b></p> |
| <p>3-Leje për objektet bujqësore dhe ruajtjen e produkteve bujqësore e blektorale, përfshirë ato frigoriferike, për përpunim të produkteve primare bujqësore e blektorale, stallave apo serave, objekte për tharjen dhe trajtimin paraprak të produkteve, sera me themel të vazhduar e pika shërbimi &gt;1000 m<sup>2</sup>.</p> | <p><b>Niveli i taksës 1% e vlerës së investimit</b></p> |

**Drejtoria e Planifikimit dhe  
Zhvillimit të Territorit**  
Ardit Janko

**Juristi**

Andi Bullari

**Drejtoria e Taksave dhe të  
Ardhurave Vendore**  
Alketa Hila

**KRYETARI**

Josif Gorrea

